



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 korrik 2024
Nr. ref.: RK 2481/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI140/23

Parashtrues

“JUGOBANKA” SH. A.

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I. -22/0049-A0001
të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 31
majit 2023**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga “Jugobanka” SH. A. (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Bajram Morina, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-I.-22-0049-A0001] të 3 shkurtit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), në ndërlidhje me Aktgjykimin [SCC-11-0248] të 14 janarit 2022, të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 20 shkurt 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese u referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, në përputhje me rregullin 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 19 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 27 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

9. Më 26 qershor 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DHPGJS) dhe iu kërkua që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
10. Në afatin e dhënë, Gjykata nuk pranoi nga DHPGJS-ja dokumentin e kërkuar.
11. Më 16 janar 2024, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin specifik për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese.
12. Më 30 janar 2024, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, përmes postës elektronike njoftoi Gjykatën se që nga fillimi i kontestit të rastit para nesh e kishte përfaqësuar parashtruesin e kërkesës para gjykatave të rregullta dhe se sipas tij bazuar në nenin 21 të Ligjit dhe paragrafin 2 të rregullit 35 të Rregullores së punës, *“nuk kërkohet autorizim specifik për Gjykatën Kushtetuese” por kërkohet vetëm autorizim, kur pala nuk e përfaqëson veten*. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi gjithashtu edhe dy autorizime gjenerale nga parashtruesi, respektivisht njëri i vitit 2009 dhe tjetri i vitit 2017.
13. Më 5 shkurt 2024, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, dorëzoi në Gjykatë parashtresën ku përsëriti të njëjtin qëndrim si në paragrafin e mësipërm.
14. Më 23 shkurt 2024, Gjykata ripërsëriti kërkesën për DHPGJS-në, duke kërkuar që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
15. Më 7 mars 2024, DHPGJS, përmes postës elektronike dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
16. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
17. Më 28 maj 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 9 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës drejtuar DHPGJS-së, kishte kërkuar caktimin e masës së përkohshme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), duke kërkuar ndalimin e shitjes së ndërmarrjeve të tij të reja.
19. Më 23 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në DHPGJS, kundër AKP-së, me propozimin që DHPGJS të vërtetojë se (i) parashtruesi i kërkesës nuk është ndërmarrje shoqërore por shoqëri aksionare jashtë juridiksionit të AKP-së; (ii) të anulojë vendimin e AKP-së për shitjen e ndërmarrjeve të reja të parashtruesit të kërkesës si dhe (iii) të ndalojë të gjitha veprimet për shitjen e tyre. Përmes padisë, parashtruesi i kërkesës theksoi se asnjëherë nuk kishte qenë ndërmarrje shtetërore por se që nga themelimi ishte organizuar si shoqëri aksionare. Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës pretendoi se nuk mund të ishte nën juridiksionin e AKP-së, pasi që sipas regjistrimit të aksionarëve, aksionarë kryesorë ishin

Jugobanka nga Beogradi, Fondi për Zhvillimin e Serbisë dhe Beobanka nga Beogradi. Tutje, në padinë e tij, parashtruesi i kërkesës theksoi se edhe po të supozohej se AKP kishte juridiksion mbi të, kushtet për shitjen e ndërmarrjeve të tij nuk ishin plotësuar pasi që Bordi i AKP-së nuk kishte caktuar statusin e tij juridik.

20. Më 29 nëntor 2011, AKP dorëzoi në DHPGJS përgjigje kundër kërkesës së parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme, përmes së cilës kundërshtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës si të pabazuara në ligj. Ndër të tjera, në përgjigjen e paraqitur, AKP theksoi se parashtruesi i kërkesës, si bankë themelore, ishte themeluar sipas Ligjit mbi kushtet dhe sistemin bankar financiar të vitit 1977, nga 112 subjekte në kapital shoqëror në bazë të Marrëveshjes Vetëqeverisëse të vitit 1977. Për më tepër, në përgjigjen e AKP-së kundër kërkesës së parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme, u theksua se transformimi ishte bërë në mënyrë të dhunshme dhe nën masat e dhunshme dhe se kundërshtohet legjitimiteti dhe vlefshmëria e vendimit për transformim, nga personat që kishin qenë pjesë e strukturave udhëheqëse të saj.
21. Më 18 maj 2012, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet propozimit të ri drejtuar DHPGJS-së kërkoi caktimin e masës së përkohshme kundër AKP-së, për ndalimin e shitjes së ndërmarrjeve të tij të reja në Prizren, Klinë dhe Mitrovicë, përmes tenderit publik të AKP-së të 30 majit 2012. Përmes propozimit për caktimin e masës së përkohshme kundër AKP-së, parashtruesi i kërkesës theksoi se shitja e këtyre ndërmarrjeve ishte e kundërligjshme pasi që sipas tij nuk ishte nën juridiksionin e AKP-së.
22. Më 15 qershor 2012, AKP dorëzoi përgjigje në DHPGJS, ndaj propozimit për caktimin e masës së përkohshme paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, duke i kundërshtuar pretendimet e këtij të fundit si të pabazuara në ligj. Ndër të tjera, AKP theksoi se parashtruesi i kërkesës ishte e organizuar si ndërmarrje shtetërore dhe se administrohej nga AKP. Për më tepër, AKP shtoi se objekti i kërkesës së masës së përkohshme lidhej me një lëndë tjetër gjyqësore, përkatësisht kishte qenë objekt i kërkesës së masës të përkohshme të kërkuar nga paditësi S. A. kundër AKP-së, kërkesë e cila ishte refuzuar.
23. Më 24 janar 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktvendimit [SCC-11-0248] refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së përkohshme kundër AKP-së, për ndalimin e shitjes së ndërmarrjeve parashtruesit të kërkesës.
24. Më 6 mars 2014, AKP parashtrroi mbrojtje në padi në DHPGJS kundër parashtruesit të kërkesës me propozimin që padia e parashtruesit të kërkesës të refuzohej si e pabazuar në ligj. AKP, tutje, theksoi se parashtruesi i kërkesës ishte organizatë bankare në pronësi shoqërore, gjë që vërtetohej edhe nga SDR i aprovuar nga AKP, dhe se vendimi për transformimin e parashtruesit të kërkesës nga Banka Themelore-Jugobanka në Mitrovicë, në degë kryesore Jugobanka SH.A. Beograd, nga 21 shtatori 1989, ishte nxjerrë në rrethana diskriminuese dhe se legjitimiteti dhe vlefshmëria e këtij vendimi kundërshtohej nga personat që në atë kohë ishin pjesë e strukturave udhëheqëse të bankës.
25. Më 27 mars 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-1-13-0021] hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës paraqitur kundër Aktvendimit [SCC-11-0248] të DHPGJS-së për refuzimin e caktimit të masës së përkohshme.

26. Më 4 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje ndaj mbrojtjes në padi të AKP-së, përmes së cilës theksoi se pretendimet e AKP-së ishin të pabazuara. Parashtruesi i kërkesës deklaroi se SDR i AKP-së ishte akt i njëanshëm dhe nuk prodhonte efekt juridik. Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar Aktvendimit [Fi 54/78] të Gjykatës Ekonomike të Qarkut të 13 janarit 1978, pretendoi se ishte vërtetuar se kishte statusin e shoqërisë aksionare.
27. Më 20 shkurt 2017, AKP parashtrroi kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së parashtruesit të kërkesës përmes së cilës pohoi se mbetej pranë deklarimeve dhe kundërshtimeve të paraqitura pranë DHPGJS-së.
28. Më 21 gusht 2017, përfaqësuesi i palës S.A., përmes parashtrësës drejtuar DHPGJS-së, kërkoi që të hyjë në procedurë në cilësinë e ndërhyrësit pasi që ishte paditës në lëndën gjyqësore [C-1-12-0040] kundër AKP-së dhe se kishte interes juridik për të mbështetur parashtruesin e kërkesës.
29. Më 14 janar 2022, Kolegji i Specializuar i DHPGS-së, përmes Aktgjykimit [SCC-11-0248], (i) refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është ndërmarrje me asete në pronësi shoqërore nën juridiksionin e AKP-së; si dhe (iii) refuzoi kërkesën e S. A. për të hyrë si palë në procedurë.
30. Përmes aktgjykimit të saj të lartpërmendur, Kolegji i Specializuar DHPGJS-së vlerësoi se fakti se parashtruesi i kërkesës është organizatë bankare në pronësi shoqërore dhe nën juridiksionin e AKP-së vërtetohet nga gjendja juridike e parashtruesit të kërkesës para 22 marsit 1989. Në këtë drejtim, në arsyetimin e aktgjykimit të lartcekur u theksua: *“Jugobanka ishte themeluar si etnitet juridik në vitin 1977, duke u bazuar në Ligjin mbi bazat e sistemit kreditor dhe bankar dhe në Marrëveshjen Vetëqeverisëse mbi bashkimin në Bankën Themelore Mitrovicë, si dhe në Statutin e Bankës Themelore Jugobanka në Mitrovicë. Jugobanka ishte e regjistruar si “Bankë Themelore” në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë sipas aktvendimit për regjistrimin në regjistrin e gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë Fi. 49/78 të datës 15 shkurt 1978 dhe kështu kishte funksionuar deri në vitin 1990. Si pasojë e transformimit, me aktvendimin Fi-2/89 të Gjykatës Ekonomike në Prishtinë është fshirë nga regjistri i gjykatës dhe më pastaj është regjistruar si subjekt i ri me aktvendimin Fi-730/91 të datës 23 maj 1991 dhe me këtë veprim edhe de juro është regjistruar si subjekt me kapital aksionar”*.
31. Më 31 janar 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër vendimit të lartpërmendur të shkallës së parë, duke pretenduar se vendimi i shkallës së parë nuk është i arsyetuar dhe se nuk janë marrë parasysh asnjë nga provat e prezentuara nga parashtruesi i kërkesës, e që kishin të bënin me vërtetimin e faktit se i njëjti nuk është ndërmarrje shoqërore por shoqëri aksionare. Në ankesë, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Kolegji i Apelit të DHPGJS-së të vërtetoj faktin se (i) parashtruesi i kërkesës është shoqëri aksionare me pronësi prej 91.77 % të numrit të përgjithshëm të aksioneve; (ii) se e njëjta nuk është nën juridiksionin e AKP-së, dhe (iii) të detyrohet kjo e fundit që parashtruesit të kërkesës t’ia pranojë statusin juridik të shoqërisë aksionare.
32. Më 3 shkurt 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [AC-I-22-0049-A0001], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke vërtetuar Aktgjykimin [SCC-11-0248] e 14 janarit 2022 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimeve të kontestuara, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
34. Pretendimi thelbësor i parashtruesit të kërkesës është se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së nuk ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke mos dhënë arsyetim të mjaftueshëm në aktgjykimin e saj si dhe ka aplikuar gabimisht “*të drejtën materiale dhe këtë duke konstatuar gabimisht dhe pa bazë ligjore se gjëja paditësi nuk është Shoqëri aksionare*”.
35. Parashtruesi i kërkesës tutje në kërkesën e tij thekson se AKP-ja me rastin e përcaktimit të statusit juridik të parashtruesit të kërkesës “*ka vendosur në kundërshtim me dispozitat e nenit 5, par.4 nënparagrafi 4.1 të Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në, si dhe në kundërshtim me parimet e nenit 1 Protokollin 1 të Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut, të cilat ka qenë e obliguar t’i zbatoj në rastin konkret bazuar në faktin jokontestues së :Transformimi i paditësit është zbatuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin bazë në bazë të cilit është bërë transformimi dhe se janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërliken me transformimin*”.
36. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se të dy instancat e DHPGJS-së në rastin konkret kanë favorizuar AKP-në.
37. Sipas parashtruesit të kërkesës, përmes refuzimit të padisë, atij i është cenuar e drejta pronësore, duke i mohuar të drejtën “*për të disponuar dhe qeverisur-administruar lirisht me të drejtat e tyre pronësore, aksionet e blera dhe të paguara në përputhje me ligjin në fuqi në atë kohë*”.
38. Në fund, parashtruesi i kërkesës, kërkon nga Gjykata të anulojë të dy vendimet, respektivisht të Kolegjit të Specializuar dhe Kolegjit të Apelit duke kthyer çështjen në rivendosje në shkallë të parë.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër

saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”

[...]

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera

LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 5

Ndërmarrjet dhe asetet nën autoritetin administrativ të agjencisë

1. Agjencia ka kompetenca ekskluzive që të administrojë:

1.1. ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;

1.2. të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 marsit 1989, përveç rasteve të rregulluara sipas paragrafit 2. të këtij neni; dhe

1.3. të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji; dhe të gjithë interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt juridik i është nënshtruar transformimit.

2. Nëse një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e asetëve të përcaktuara në nënparagrafi 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni një organi tjetër publik, Agjencia nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregulloreje.

3. Autoriteti administrativ i Agjencisë i paraparë në nenin 5, paragrafi 1.1. do të vlejë për të gjitha pronat në pronësi apo posedim të ndërmarrjes, përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës; me kusht që - dhe pavarësisht nga detyrimet e Agjencisë të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1-lidhur me ato prona që gjenden jashtë Kosovës, Agjencisë i kërkohet vetëm të ushtrojë autoritetin e vet mbi ato prona deri në masën që Agjencia e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë siç referohen në nenin 7.1. të këtij ligji. Gjatë vendimmarrjes mbi këto çështje, Agjencia merr parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës.

4. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni si dhe neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, përveç nëse:

4.1. transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në bazë të cilit është bërë transformimi;

4.2. janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me transformimin, qofshin ato që kanë dalë gjatë apo pas transformimit, qofshin ato të shqiptuara në bazë të ligjit apo ndonjë kontrate – përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, përmbushjen e plotë të detyrimeve që kërkojnë pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve; dhe

4.3. transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,

5. Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe kompetencave të saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji në lidhje me një ndërmarrje e cila i është nënshtruar transformimit, Agjencia ka të

drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni, përveç nëse Agjencia ka në dispozicion prova bindëse të gatshme të cilat vërtetojnë se transformimi i përmbush këto kushte. Në raste të këtilla zbatohet paragrafi 6. të këtij neni.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

39. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

40. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

6. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

41. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

42. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridik (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. [KI41/09](#), parashtruesi i

kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe [KI35/18](#), me parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).

43. Gjykata gjithashtu konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar; (ii) konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimit [AC-I.-22-0049-A0001] të 3 shkurtit 2023 të Kolegjit të Apelit; (iii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; (iv) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
44. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

45. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore, përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
46. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

47. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës në DHPGJS, kundër AKP-së, me propozimin që DHPGJS të vërtetojë se (i) parashtruesi i kërkesës nuk është ndërmarrje shoqërore por shoqëri aksionare jashtë juridiksionit të AKP-së; (ii) të anulojë vendimin e AKP-së për shitjen e ndërmarrjeve të reja të parashtruesit të kërkesës si dhe (iii) të ndalojë të gjitha veprimet për shitjen e tyre, duke pretenduar se asnjëherë nuk kishte qenë ndërmarrje shtetërore por se që nga themelimi ishte organizuar si shoqëri aksionare. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pranë DHPGJS-së kishte kërkuar edhe vendosjen e masës së përkohshme kundër Vendimit të AKP-së për shitjen e pronave të parashtruesit të kërkesës. Kërkesa e parashtruesit të kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme ishte refuzuar nga Kolegji i Specializuar dhe më pas edhe nga Kolegji i Apelit. Lidhur me kërkesëpadinë kryesore të parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Specializuar kishte refuzuar të njëjtën duke theksuar se parashtruesi i kërkesës është ndërmarrje me asete në pronësi shoqërore nën juridiksionin e AKP-së. Vendimi i Kolegjit të Specializuar, pas ankesës së parashtruesit të kërkesës ishte vërtetuar edhe nga Kolegji i Apelit.
48. Parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e mësipërme të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
49. Së pari, lidhur me pretendimet e parashtruesit kërkesës për shkeljen e neneve 7 [Vlerat], 21 [Parimet e Përgjithshme], 24 [Barazia para Ligjit], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, Gjykata nga kërkesa e parashtruesit të kërkesës vëren se lidhur me këtë, ky i fundit vetëm ka përmendur shkeljen e neneve të Kushtetutës, duke mos ofruar asnjë arsyetim dhe duke mos mbështetur pretendimin e tij rreth mënyrës se si vendimi i kontestuar, përfshirë edhe vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, mund të kenë rezultuar në shkeljen e këtyre të fundit.
50. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e neneve të sipërcituara, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
51. Në thelb, Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të tij para Gjykatës, ka të bëjë me: (i) pretendimin e tij për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, përfshirë pretendimin për zbatim të gabuar të ligjit; si dhe (ii) pretendimin për cenim të së drejtës në pronë, duke pretenduar se i është mohuar e drejta e tij për gëzim paqësor të pronës.
52. Prandaj, nga si më sipër, Gjykata do të trajtojë ndaras pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke filluar me pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të

Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës e që ndërlihdhet me pretendimin e tij për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor, përfshirë pretendimin për zbatim të gabuar të ligjit, për të vazhduar më pas me pretendimin e tij për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

53. Lidhur me pretendimin e tij për mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor të cilin parashtruesi e ndërlihdë edhe me zbatim të gabuar të ligjit, Gjykata së pari do të paraqes parimet e përgjithshme përkitazi me vendimin e arsyetuar gjyqësor dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rastin konkret.

I. Pretendimet përkitazi me mosarsyetim të vendimit gjyqësor

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar

54. Garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsyetim të mjaftueshëm për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 113). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.
55. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, [nr. 37801/97](#), Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; *Carmel Saliba kundër Maltës*, [nr. 24221/13](#), Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73; dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 114).
56. Gjykata më e ulët ose autoriteti shtetëror, nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyetime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, [nr. 49684/99](#), Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 115).
57. Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, [nr. 16034/90](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [nr. 30544/96](#), Aktgjykim i 29 janarit 1999, paragrafi 26; *Perez kundër Francës*, [nr. 47287/99](#), Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 116).
58. Nga natyra e vendimit që merr gjykata, varet nëse Gjykata është e detyruar ta arsyetojë atë, dhe kjo mund të vendoset vetëm në dritën e rrethanave të rastit në fjalë: është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë midis sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjytimeve (shih, rastet e GJEDNJ-së *Ruiz Torija kundër Spanjës*, [nr. 18390/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, [nr.](#)

[18064/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 117).

59. Megjithatë, nëse parashtrësja e një pale është vendimtare për rezultatin e procedurës, ajo kërkon që t'i përgjigjet në mënyrë specifike dhe pa vonesë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Ruiz Torija kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 30; *Hiro Balani kundër Spanjës*, të cituar më lart, paragrafi 28 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 118).
60. Prandaj, gjykatat janë të obliguara që:
1. të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, [nr. 61302/00](#), Aktgjykim i 24 gushtit 2005, paragrafi 67; *Donadze kundër Gjeorgjisë*, [nr. 74644/01](#), Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35); dhe
 2. të shqyrtojnë me shumë rigozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNJ dhe Protokollin e saj (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Fabris kundër Francës*, [16574/08](#), Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 72; *Wagner dhe JMWL kundër Luksemburgut*, [nr. 76240/01](#), Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
61. Neni 6, paragrafi 1, nuk kërkon që Gjykata Supreme të japë një arsyetim më të detajuar kur ajo thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Burg dhe të tjerët kundër Francës*, [nr. 34763/02](#); Vendim i 28 janarit 2003; *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2), [nr. 12686/03](#), Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41; dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 120).
62. Në mënyrë të ngjashme, në një rast ku bëhet fjalë për një kërkesë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën e një gjykate më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Kukkonen kundër Finlandës* (nr. 2), [nr. 47628/06](#), Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; *Bufferne kundër Francës*, [nr. 54367/00](#), Vendim i 26 shkurtit 2002; dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 121).
63. Përveç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, *Tatishvili kundër Rusisë*, [nr. 1509/02](#), Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt merrej me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Helle kundër Finlandës*, [nr. \(157/1996/776/977\)](#), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 122). Kjo kërkesë është aq më e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.

64. Megjithatë, gjykatat e apelit (në shkallën e dytë) të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Hansen kundër Norvegjisë*, nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77–83 dhe rastin e Gjykatës [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 123).

(ii) *Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

65. Së pari, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimet e parashtruesit që ndërlidhen me mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera thekson se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk ka adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës duke mos dhënë arsyetim të mjaftueshëm në aktgjykimin e saj si dhe ka aplikuar gabimisht “*të drejtën materiale dhe këtë duke konstatuar gabimisht dhe pa bazë ligjore se gjëja paditësi nuk është Shoqëri aksionare*”.

66. Parashtruesi i kërkesës më tutje thekson se Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, “*ka anashkaluar faktin relevant se e paditura [AKP] nuk ka ingerenca të Gjykatës e as kompetencë për të caktuar statusin juridik të një subjekti ekonomik (këtu te paditësi si person juridik) i cili ka një Vendim të plotfuqishëm gjyqësor lidhur me statusin e tij juridik*”, duke u thirrur në një Aktvendim [Fi. nr. 730/91] të 23 majit 1991.

67. Në vijim, Gjykata rikujton arsyetimin e Aktgjykimit [SCC-11-0248] të 14 janarit 2022 të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së i cili refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi se parashtruesi i kërkesës është ndërmarrje me asete në pronësi shoqërore nën juridiksionin e AKP-së. Në vijim do të reflektohen pjesë të caktuara të aktgjykimit të lartcekur, të cilat ndërlidhen me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

68. Përmes aktgjykimit të saj të lartpërmendur, Kolegji i Specializuar DHPGJS-së vlerësoi se fakti se parashtruesi i kërkesës është organizatë bankare në pronësi shoqërore dhe nën juridiksionin e AKP-së vërtetohet nga gjendja juridike e parashtruesit të kërkesës para 22 marsit 1989.

69. Për më tepër, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në aktgjykimin e tij thekson se parashtruesi i kërkesës ishte themeluar në vitin 1977 nga 112 subjekte që afronin me kapital shoqëror në bazë të Marrëveshjes Vetëqeverisëse të vitit 1977 dhe se sipas nenit 49 të Ligjit mbi kushtet dhe sistemin financiar të vitit 1977, ishte themeluar si bankë themelore. Në këtë aspekt, DHPGJS vlerësoi se nga Marrëveshja Vetëqeverisëse mbi Bashkimin në Bankën Themelore Jugobanka në Mitrovicë, vërtetohej se shumica e themeluesve të bankës ishin organizata bazë dhe organizata të punës së bashkuar dhe se asetet e tyre përbënin kapital shoqëror. Gjithashtu, në arsyetimin e aktgjykimit të saj, DHPGJS theksoi se edhe nga SDR i AKP-së i 10 gushtit 2011 ishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës ishte subjekt juridik i cili është qeverisur mbi bazë të kapitalit me pronësi shoqërore.

70. Lidhur me transformimin që kishte pësuar parashtruesi i kërkesës, në arsyetimin e aktgjykimit të lartpërmendur, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së vlerësoi se miratimi i vendimit për transformim ishte bërë nga organet e përkohshme të vendosura në subjektet themeluese të parashtruesit të kërkesës, përfaqësuesit e të cilave, pas instalimit të masave të dhunshme, kishin dhënë pëlqimin për themelimin e një banke të re me kapital aksionar.

Sipas Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, nga Statuti themeltar i vitit 1977 dhe dokumentacioni i parashtruesit të kërkesës, konkludohej se ishte në pronësi shoqërore, nën administrimin e AKP-së. Për më tepër, përmes Aktgjykimit [SCC-11-0248], DHPGJS, shtoi se transformimet e bëra, veçanërisht pas datës 22 mars 1989, ishin të pabazuara në ligjet pozitive dhe në kundërshtim me rendin juridik e kushtetues, pasi që ishin të instaluar masat e dhunshme në institucionet publike dhe ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Rrjedhimisht, DHPGJS vlerësoi se pasi që në kohën kur ishte ndryshuar statusi i ndërmarrjes, punëtorëve shqiptarë iu ishte ndërprerë marrëdhënia e punës kundër vullnetit të tyre, transformimi në fjalë nuk ka qenë ligjor dhe jodiskriminues.

71. Tutje, në aktgjykimin e lartpërmendur shtohet se barra e të provuarit në rastin konkret bie mbi parashtruesin e kërkesës lidhur me faktet dhe argumentet që e mbështetë padinë, dhe në rastin konkret *“vendimet transformuese nuk janë nxjerrë në rrethana diskriminuese dhe kështu për të vërtetuar legjitimitetin dhe vlefshmërinë e këtyre veprimeve nën rrethanat që kanë ekzistuar në at kohë”*.
72. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se i njëjti ka statusin e shoqërisë aksionare, vërtetuar edhe përmes aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren të vitit 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së thekson se sipas atij aktgjykimi *“ishin liruar nga akuza D.K dhe E.I të cilët ishin akuzuar se njëri në cilësi të drejtorit të Jugobankës kishte nënshkruar kontratën për shitjen e një lokali aset [...] Është krejtësisht e pavend që paditësja të mbështes kërkesëpadinë e saj në një rast penal, me pohimin se gjykata e ka konfirmuar se paditësja nuk është NSH por SHA*.
73. Më tej, Gjykata i referohet edhe Aktgjykimit [AC-I-22-0049-A0001] të 3 shkurtit 2022 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i cili refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës duke vërtetuar vendimin e shkallës së parë. Kolegji i Apelit të DHPGJS-së në arsyetim të aktgjykimit të tij theksoi se pajtohet në tërësi me gjetjet e vendimit të shkallës së parë duke shtuar se *“të gjitha dokumentet e prezentuara nga paditësja, do të ishin të pranueshme për secilën gjykatë dhe secilin gjyqtar, nëse nuk do të ishin lëshuar dhe nxjerrë në një ambient normal juridik e politik. Në rastin specifik në këto dëshmi dhe prova në të cilat thirret ankuesja rezultojnë të jenë nga një periudhë të diskriminimit ndaj shumicës së popullatës në Kosovë, në një periudhë të përjashtimeve masive të punëtorëve dhe udhëheqësve shqiptarë në NSH, në një periudhë të transformimeve antiligjore dhe masive të të gjitha sistemeve ekzistuese në Kosovë, si pasojë e suprimimit të autonomisë ekzistuese në atë kohë në Kosovë dhe si pasojë e politikës agresive antishqiptare të pushtetit të atëhershëm serb”*.
74. Gjykata vëren se në thelb, gjykatat e rregullta kishin refuzuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës, duke dhënë arsyeime në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës, respektivisht duke sqaruar faktin se parashtruesi i kërkesës ishte themeluar si organizatë në vitin 1977 nga 112 subjekte që afronin me kapital shoqëror në bazë të Marrëveshjes Vetëqeverisëse të vitit 1977 dhe se sipas nenit 49 të Ligjit mbi kushtet dhe sistemin financiar të vitit 1977, ishte themeluar si bankë themelore, dhe se miratimi i vendimit për transformim ishte bërë nga organet e përkohshme të vendosura në subjektet themeluese të parashtruesit të kërkesës, përfaqësuesit e të cilave, pas instalimit të masave të dhunshme, kishin dhënë pëlqimin për themelimin e një banke të re me kapital aksionar.
75. Si pasojë e gjithë asaj që u tha më lart, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, kanë dhënë arsye bindëse dhe të mjaftueshme për refuzimin e ankesës së parashtruesit duke u bazuar në të gjitha argumentet e tyre të reflektuara më lart.

76. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
77. Përveç kësaj, Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar dhe vendimi i shkallës së parë, përmban arsyetim logjik dhe sqaron me saktësi të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës (shih, rastet e GJEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 28).
78. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesi i kërkesës përkitazi me rastin konkret ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqet pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare në mënyrë efektive; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës; dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kontestuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih, rastet e GJEDNJ-së, [García Ruiz kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; dhe rastet e Gjykatës [KI22/19](#), parashtrues [Sabit Ilazi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; si dhe rasti [KI128/18](#), parashtrues [Limak Kosovo Airport SH.A. "Adem Jashari"](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 27 majit 2019, paragrafi 58).
79. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshëm gjyqësor dhe zbatimit të gabuar të ligjit, janë (i) pretendime që i takojnë kategorisë së "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

II. Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtës në pronë

80. Gjykata rikujton pretendimet e parashtruesit të kërkesës, i cili thekson se i është cenuar e drejta në pronë "*për të disponuar dhe qeverisur-administruar lirisht me të drejtat e tyre pronësore, aksionet e blera dhe të paguara në përputhje me ligjin në fuqi në atë kohë*".
81. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës, sikundër edhe neni 1 i Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e Pronës) i KEDNJ-së nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës (shih, rastet e Gjykatës [KI201/18](#), parashtrues [Selami Taralcu](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2019, paragrafi 39; [KI83/18](#), parashtrues [Ivica Milošević](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 17 tetorit 2019, paragrafi 41; shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së [Van der Mussele kundër Belgjikës](#), nr. 8919/80, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48).
82. Parashtruesi i kërkesës më tej mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "pronën" e tij; brenda kuptimit të kësaj dispozite "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në

bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës mund të pretendojnë "prishmëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore.

83. Por, sipas praktikës së GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih, rastet e GJEDNJ-së [*Kopecky kundër Sllovakisë*](#), nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50).
84. Gjykata, duke i trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me parimet e lartpërmendura, vëren se parashtruesi nuk e ka arsyetuar në veçanti shkeljen e së drejtës së pronës dhe nuk i referohet konkretisht ndonjë prej parimeve të përmbajtura në nenin 46 të Kushtetutës, por konsideron se kjo e drejtë i është shkelur si pasojë e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (nenit 31 të Kushtetutës) për sa i përket mos arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kjo për faktin se, sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe në këtë mënyrë nuk kanë vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së tij.
85. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata tashmë ka ardhur në përfundim se këto pretendime janë qartazi të pabazuara. Prandaj, Gjykata konsideron se në rastin konkret nuk dëshmohet se parashtruesi i kërkesës ka kërkesë të arsyetuar lidhur me shkeljen e të drejtës së pronës sipas nenit 46 të Kushtetutës.
86. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe cilësohet si pretendim që i takon kategorisë së pretendimeve "*të pambështetura apo të paarsyetuara*", prandaj deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 34, paragrafi (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 dhe 116. 2 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 28 maj 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. TË KONSTATOJË se ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani